

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 866, datë 20.12.2018

PËR PROCEDURAT DHE MODELIN E VLERËSIMIT TË RISKUT PËR RASTET E DHUNËS NË FAMILJE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, si dhe të neneve 7, pika 1, shkronja “b”/1 e 25 pika 2, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ministri i Brendshëm dhe ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

UDHËZOJNË:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Ky udhëzim përcakton procedurat për kryerjen e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit dhe modelin e këtij vlerësimi.

2. Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi, për referencë do të përdoren përkufizimet dhe shkurtime si më poshtë vijon:

a) “Vlerësimi i riskut”, faza e menaxhimit të rastit të dhunës në familje, që kryhet menjëherë në mënyrë të shpejtë, pas identifikimit ose raportimit të rastit, me qëllim ndalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimës përmes Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM).

b) UPMMP – urdhri i lëshuar nga Policia e Shtetit në bazë të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

c) UMM – Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes i lëshuar me vendim të gjykatës në bazë të ligjit nr. 9669/2006.

ç) UM – Urdhri i Mbrojtjes i lëshuar me vendim të gjykatës në bazë të ligjit nr. 9669/2006.

d) Punonjësi i policisë – punonjësi i policisë që do të kryejë vlerësimin e riskut dhe procedurat për lëshimin e UPMMP-së.

dh) Struktura përgjegjëse – struktura përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit në bazë të ligjit nr. 9669/2006.

e) Raporti – raporti për vlerësimin e riskut, i hartuar nga Policia e Shtetit.

II. Detyrat e Policisë së Shtetit për vlerësimin e riskut

3. Titullari i strukturës përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit, menjëherë pas identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës në familje, ku është identifikuar ose raportuar rasti, merr të gjitha masat për të ndaluar dhunën dhe për të kryer procedurat për vlerësimin e riskut dhe lëshimin e UPMMP-së.

4. Struktura përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit dhe koordinatori vendor afishojnë në vende të dukshme në ambientet përkatëse listën e personave të kontaktit dhe numrin e telefonit, për institucionet pjesë e mekanizmit të referimit. Koordinatori vendor përgatit dhe përditëson periodikisht këtë listë.

5. Punonjësi i Policisë së Shtetit i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit të riskut njofton koordinatorin vendor pranë njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore. Ky i fundit, mund të asistojë në hartimin e raportit të vlerësimit të riskut për rastin e dhunës në familje. Në pamundësi për t’u paraqitur personalisht, zëvendësohet menjëherë nga një punonjës social i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

6. Struktura përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit, në rastin kur fëmijët janë viktimë të dhunës së drejtpërdrejtë në familje, menjëherë pas marrjes në mbrojtje të fëmijës dhe referimit të rastit pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki / punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në njësitë administrative të Bashkisë, harton raportin e vlerësimit të riskut në prani të përfaqësuesit të kësaj të fundit.

7. Mosparaqitja në kohë e koordinatorit vendor / punonjësit social të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në njësitë e vetëqeverisjes vendore, nuk përbën shkak për ndërprerjen e vlerësimit të riskut ose për vonesa në hartimin e raportit.

8. Nëse vendi ku është identifikuar ose raportuar rasti i dhunës në familje është i ndryshëm nga ai i vendbanimit të viktimës ose dhunuesit, punonjësi i policisë i ngarkuar të kryejë vlerësimin e riskut mund të kërkojë informacion nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit të vendbanimit të tyre.

9. Raporti për vlerësimin e riskut hartohet sipas aneksit, që është pjesë përbërëse e udhëzimit. Modeli i aneksit shërben për të siguruar kërkesat minimum të raportit për vlerësimin e riskut, i cili mund të përmbajë edhe elemente të tjera sipas rastit të dhunës që vlerësohet.

10. Raporti i vlerësimit të riskut shpreh nivelin e rrezikut për rastin konkret dhe sugjeron në proporcion me të, një ose disa nga masat e parashikuara në ligjin nr. 9669/2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në fuqi.

11. Një kopje e raportit u njoftohet menjëherë titullarit të strukturës përgjegjëse dhe punonjësve që thirren për hartimin e këtij raporti.

III. Vlerësimi i riskut në rastin e dhunës në familje

12. Vlerësimi i riskut kryhet me shpejtësi, bazuar në informacionin që disponohet si rezultat i identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës, si dhe të informacioneve të tjera që mund të mblidhen menjëherë nga pyetja e të dhunuarës, e dhunuesit ose e anëtarëve të tjerë të familjes, si dhe nga institucionet, organizatat ose individët, që kanë dijeni për rastin.

13. Mbledhja e informacionit synon të krijojë të dhëna në lidhje me: disponimin e armëve, jo vetëm në rastet kur dyshohet për armëmbajtje pa leje, por edhe në rastet kur një e tillë disponohet me leje; rastet e përsëritura të dhunës në familje dhe burimit të saj, nëse ka pasur edhe më parë urdhra gjyqësorë të mbrojtjes apo masa të mbrojtjes së menjëhershme; qëndrimin e dhunuesit/es ndaj urdhrave të mëparshëm për mbrojtjen nga dhuna në familje; mbi vendimet gjyqësore penale ndaj tij; gjendjen psikologjike të dhunuesit/es, nëse është përdorues i lëndëve alkoolike, narkotike ose nëse përbën kërcënim për jetën, shëndetin a lirinë e viktimës, të fëmijëve ose të anëtarëve të tjerë të familjes.

14. Për hartimin e raportit për vlerësimin e riskut punonjësi i policisë analizon:

a) nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes dhe dinamikën e mundshme të zhvillimit të tij;

b) nevojën për të marrë masë paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kohëzgjatjen e zbatimit të saj;

c) nevojën për të parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të dhunës, përmes ndalimit të veprimeve të dhunuesit.

15. Punonjësi i policisë, pasi ka analizuar vlerësimin e riskut sipas pikës 14 të këtij udhëzimi, harton raportin e vlerësimit të riskut. Këtë raport ia paraqet titullarit të strukturës vendore të policisë, duke sugjeruar:

a) miratimin e urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nëse është rasti;

b) marrjen e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, që duhet të urdhërohen në UMPMM për ndalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimës, duke u bazuar në parimin e parandalimit të përshkallëzimit të dhunës dhe të proporcionalitetit me nivelin e rrezikut të dhunës, parimin e interesit më të lartë të fëmijës, si edhe shmangien e lënies së fëmijëve pranë dhunuesit;

c) vendosjen e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence, e cila sugjerohet vetëm kur paraqitet e domosdoshme për shkak të riskut për jetën e saj, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve të mitur për të mos qëndruar me dhunuesin/en në mënyrë të pambikëqyrur, vullnetin e viktimës për t'u strehuar, si dhe legjislacionin në fuqi për standardet dhe procedurat për pranimin në këto qendra;

ç) vendosjen e viktimës pranë qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale;

d) zbatimin e UMPMM-së, në rastin e dhunës së ushtruar drejtpërdrejt mbi fëmijët në qasje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve, nën përgjegjësinë e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve;

dh) marrjen edhe të masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme për menaxhimin e riskut dhe zbatimin e UMPMM-së, të cilat koordinohen me institucionet përkatëse nga koordinatori vendor dhe Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në familje;

e) lëshimi i UMPMM-së nuk pengon ndjekjen penale të dhunuesit, nëse është rasti.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM

Sandër Lleshaj

MINISTËR I SHËNDETËSISË

DHE MBROJTJES SOCIALE

Ogerta Manastirliu

ANEKS
MODEL I RAPORTIT PËR VLERËSIMIN E RISKUT PËR RASTIN E DHUNËS NË
FAMILJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË
KOMISARIATI I POLICISË _____

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____._____

RAPORT

PËR VLERËSIMIN E RISKUT PËR RASTIN E DHUNËS NË FAMILJE

I. Të dhëna për raportin dhe hartuesit

1.	Data, ora, vendi, ku hartohet raporti
2.	Emri, mbiemri dhe detyra për punonjësën e policisë që vlerëson riskun.
3.	Persona të tjerë sipas këtij udhëzimi, (emri, mbiemri dhe detyra).

II. Burimet e marrjes së informacionit

1.	Rasti i identifikuar/raportuar, mënyra se si është identifikuar rasti dhe koha e identifikimit, vendi ku ka ndodhur rasti, adresa.
2.	Intervista me subjektin dhunues/të dyshuarin. Identiteti/Emri, mbiemri, atësia, datëlindja dhe vendlindja, vendbanimi adresa e saktë; Përshkrim i shkurtër:
3.	Intervista me viktimën. Identiteti/Emri, mbiemri, atësia, datëlindja dhe vendlindja, vendbanimi adresa e saktë; Përshkrim i shkurtër
4.	Intervista me persona të tjerë/ankuesin/raportuesin e dhunës. Identiteti/Emri, mbiemri, atësia, datëlindja dhe vendlindja, vendbanimi adresa e saktë; Përshkrim i shkurtër:
5.	Të dhëna të tjera të policisë ose të institucioneve të tjera.

--	--

III. Përmbledhje dhe përshkrim i historisë së dhunës

1. Përshkruaj ngjarjen e fundit. Kur? _____ Kush? _____ Pse? (shkaqe, qëllimi) _____ Ku? _____ Dëmi i ardhur _____ A janë dhunuar fëmijët? A është ushtruar dhunë në prani të tyre? _____ Të tjera. _____
2. Përshkruaj ngjarjet e kaluara. Episodi 2 _____ Episodi 3 _____

IV. Faktorët e riskut nga dhunuesi/ja. Gjendja në të shkuarën dhe ajo aktuale

1. Konflikt me ligjin/dhunë seksuale/armëmbajtje pa leje/vepra të tjera penale, _____ 2. Përsëritjet e dhunës dhe përshkallëzimi, _____ 3. Probleme nga përdorimi i alkoolit/narkotikëve, _____ 4. Probleme të shëndetit mendor, _____ 5. Konsiderata të tjera, _____
--

V. Faktorët e riskut për viktimën. Gjendja në të shkuarën dhe ajo aktuale.

1. Frikë nga autori i krimit. _____
2. A është larguar nga shtëpia? A dëshiron të largohet nga shtëpia? _____
3. Probleme shëndetësore _____
4. Cila është gjendja e fëmijëve që kanë qenë të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës? Reagimi i tyre? _____
5. Konsiderata të tjera. _____ _____

VI. Vlerësimi i riskut/Cilat janë masat më të përshtatshme?

☐ A ka risk për të kryer dhunë në të ardhmen? ☐ Risk për jetën?	☐ Urgjent ☐ I moderuar ☐ I ulët
☐ A është e nevojshme të lëshohet UMPMM?	☐ Po ☐ Jo Shënime:
☐ Cila nga masat e parashikuara në ligj janë më të përshtatshme në këtë rast? <i>(plotëso më poshtë)</i>	
Shënime: <i>(Jepni sqarimet e nevojshme)</i>	a) urdhërimi i dhunuesin/es që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;
Shënime:	b) urdhërimi i dhunuesit/es që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën ose pjesëtarë të familjes së viktimës;
Shënime:	c) ndalimi menjëherë i dhunuesin/es, që t'i afrohet: ☐ strehës, ☐ vendit të punës, ☐ banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë, ☐ dhe institucioneve arsimore, ☐ ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimat, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;
Shënime:	ç) vendosja menjëherë e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata;
Shënime:	d) urdhërimi i një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës, sipas shkronjës “ç”, të kësaj pike;

Shënime:	dh) urdhërimin e një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;
Shënime:	e) ☐ bllokimi i çdo arme me leje që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer, ☐ sekuestrimi i çdo arme pa leje që i përket atij, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.
☐ Sugjerime të tjera të përshtatshme për zbatimin e UMPMM-së	Shënime:

VII. Shënime të fundit

1. Hartoi raportin: _____ <i>(emër, mbiemër, firmë)</i>	
2. Asistuan në përgatitjen e raportit (nëse ka): 	
2.1	_____ <i>emër, mbiemër, firmë.</i>
2.2	_____
Bashkëlidhur, dokumentet (nëse ka): 	
1.	_____
2.	_____

